



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca: 626-20-031-1-3-5

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik "EUROPRINTY" SH.P.K & "P.C. COMP" Sh.p.k., me numer të biznesit: **810444878**, selia Rruga e **HEKURUDHËS, 10000, FUSHË KOSOVË** i përfaqësuar me autorizim nga z. **Veli Musa**, në cilësinë e **punëtorit** të Operatorit Ekonomik (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizime si më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

Furnizim me kompjuterë dhe laptop për zyrtarët e Komunës së Mamushës-Ritender
(Sipas marrëveshjes së AQP-s për furnizimin me pajisje te TI-s)

Numri i Prokurimit: 626-20-6892-5-5-8

Neni 1 Lënda

- 1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me furnizimin me kompjuter, laptop dhe monitor për zyrtarët e Komunës së Mamushës si më poshtë:

Specifikimet teknik minimale				
Nr.	Model	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia
1	Brand name PC Model I	Prodhuesi: Brand Name. Sistemi operativ: Windows 10 Pro 64 bit I instaluar. Procesori: Min: Intel Core i5, min gjenerata e parafundit në datën e ftesës për ofertë. Min. 8GB, DDR4-2400 Mhz. HDD:Min 128 GB SSD 2.5" dhe 500 HDD SATA 6Gb/s. Lexuesi optik: DVD Drive. Kartela grafike: Minimum dy porte: VGA+DP, ose HDMI+DP, ose HDMI+VGA ose DVI-D+VGA ose kombinimet tjera me të mira. Porte: Min. 2XUSB 3.0, total min 6 porte. Rjeti min. 1xRJ45 Gigabit port. Mausi dhe tastiera: USB Mouse & QWERTY Keyboard. Tjera: EU-US ENERGY STAR. Audio: Integrated sound card. Power: EU Standard. Garancioni: min. 3 vite	Copë	14
2	Brand name Monitor	Prodhuesi: Brand Name. Panel size: Min. 21". Aspect Ratio: 16:9, Widescreen. Resolution: 1920x1080, IPS, ore beter. Contrast Ratio: 1000:1,	Copë	14



	Model I	ore better. Voltage Required: EU Standard. Connectivity: Minimum dy porte: VGA+DP, ose HDMI+DP, ose HDMI+VGA ose DVI-D+VGA ose kombinimet tjera më të mira. Included: AC, min. dy kablo te "Conectivity" varesisht monitorit. Other features: min EU-US ENERGY STAR Compliant. Stand: Tilt. Garancioni minimum 3 vite.		
3	Brand name Laptop-Model III	Prodhuesi: Brand Name. Sistemi operativ: Windows 10 Pro 64 bit I instaluar. Procesori: Min: Intel Core i5, min gjenerata e parafundit në datën e ftesës për ofertë. Memorie Min. 4GB, 2400 Mhz DDR4. HDD:Min 250 GB Kartela grafike: integrated HD Graphics. Monitor min. 13"-Max 14" Bateria: Battery life 8+ hours. Porte shtesë: Min. 2x USB 3.0, HDMI ore Display, wifi inclded. AV: Integrated camera, HD audio speakers, integrated microphone AC Included+bag. tjera: AU-US ENERGY STAR. KEYBOARD/Touchpad: Keyboard with Qwerty. Garancioni minimum 3 vite.	Copë	1

1.2 Kontrata do të hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të sajë nga ana e të dy palëve, ndërsa do të përfundoj pas furnizimit të të gjitha artikujve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 15 (Pesëmbëdhjetë) ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi kryesor i dorëzimit ose i realizimit është Ndërtesa e Komunës në Mamushë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **6,986.00 €; Gjashtmijë e nëntqindë e tetëdhjetë e gjashtë Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet të jetë i përcaktuar në të gjitha aspektet të plotësorëve të specifikimit teknik të parashtruar në Dosjen e Tenderit.

7.1 Operatori ekonomik duhet të ofroj materialet e kualitetit të lartë të përshkruar sipas specifikacionit teknik të cekur në dosjen e tenderit. Periudha minimale e garancionit është 3 (Tri) vite.

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c).



Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Veli Musa	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Punëtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	03.12.2020	Data:	03.12.2020
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i prokurimit: *Furnizim me kompjuterë dhe laptop për zyrtarët e Komunës së Mamushës-Ritender*

Nr i prokurimit: 626-20-6892-5-5-8

Nr i brendshëm: 626-20-031-1-3-5

Nr.	Model	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi €	Totali €
1	Brand name PC Model I	Prodhuksi: Brand Name. Sistemi operativ: Windows 10 Pro 64 bit i instaluar. Procesori: Min: Intel Core i5, min gjenerata e parafundit në datën e ftesës për ofertë. Min. 8GB, DDR4-2400 Mhz. HDD: Min 128 GB SSD 2.5" dhe 500 HDD SATA 6Gb/s. Lexuesi optik: DVD Drive. Kartela grafike: Minimum dy porte: VGA+DP, ose HDMI+DP, ose HDMI+VGA ose DVI-D+VGA ose kombinimet tjera me të mira. Porte: Min. 2XUSB 3.0, total min 6 porte. Rjeti min. 1xRJ45 Gigabit port. Mause dhe tastiera: USB Mouse & QWERTY Keyboard. Tjera: EU-US ENERGY STAR. Audio: Integrated sound card. Power: EU Standard. Garancioni: min. 3 vite	Copë	14	375	5,250.00€
2	Brand name Monitor Model I	Prodhuksi: Brand Name. Panel size: Min. 21". Aspect Ratio: 16:9, Widescreen. Resolution: 1920x1080, IPS, ore beter. Contrast Ratio: 1000:1, ore better. Voltage Required: EU Standard. Connectivity: Minimum dy porte: VGA+DP, ose HDMI+DP, ose HDMI+VGA ose DVI-D+VGA ose kombinimet tjera më të mira. Included: AC, min. dy kablllo të "Connectivity" varesisht monitorit. Other features: min EU-US ENERGY STAR Compliant. Stand: Tilt. Garancioni minimum 3 vite.	Copë	14	89	1,246.00€
3	Brand name Laptop- Model III	Prodhuksi: Brand Name. Sistemi operativ: Windows 10 Pro 64 bit i instaluar. Procesori: Min: Intel Core i5, min gjenerata e parafundit në datën e ftesës për ofertë. Memorie Min. 4GB, 2400 Mhz DDR4. HDD: Min 250 GB. Kartela grafike: Integrated HD Graphics. Monitor min. 13". Max 14" Bateria: Battery life 8+ hours. Porte shtesë: Min. 2x USB 3.0, HDMI ore Display, wifi included. AV: Integrated camera, HD audio speakers, integrated microphone AC Included+bag. tjera: AU-US ENERGY STAR. KEYBOARD/Touchpad: Keyboard with Qwerty. Garancioni minimum 3 vite.	Copë	1	490	490.00€
Totali i përgjithshëm duke i përfshirë të gjitha taksat dhe tatime e aplikuar			6986.00			

Emri i OE:	EUROPRINTY SHPK
Adresa e plotë:	YMER ALIU NR.70
I përfaqësuar nga:	
Emri dhe Mbiemri:	HAJRIZ ZABELI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	02/11/2020
Vula:	